



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE PEJË**  
OSNOVNI SUD PEĆ – BASIC COURT PEJA

**P nr.632/16**

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA THEMELORE NË PEJË D.P, gjyqtari Sejdi Blakaj me sekretaren juridike Gjyljeta Çorkadiu , në lëndën penale kundër të pandehurit Sh. Z , sipas aktakuzës së PTH-së D.P. në Pejë PP/II.nr .810/16 të dt.22.7.2016, për shkak të veprës penale: posedimi i paautorizuar i narkotikëve , substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par 1 të KPRK-së, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar , publik dhe me gojë, të mbajtur në praninë e të pandehurit Sh. Z dhe të prokurorit të shtetit Ardita Beqiraj me dt.17.8.2017 ka marrë dhe botërisht ka shpallë këtë :

**A K T G J Y K I M**

**I pandehuri Sh. Z i lindur me dt.....në..... , i biri i G dhe nënës H e gjinisë Sh, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës , gjendet në liri.**

**ËSHTË FAJTOR**

Për arsye se:

Me dt. 21.2.2016 rreth orës 21:30 , në fsh. .... , pa autorizim ka poseduar narkotikë dhe substanca psikotrope të shpallura si të rrezikshme , në atë mënyrë që i pandehuri nga persona deri me tani të panjohur është furnizuar me substancë narkotike të llojit Marihuan , në peshë prej 13.90 gram e me qelli të përdorimit , e ku kjo substancë është gjetur dhe konfiskuar ditën kritike nga patrulla e policisë në Pejë , pikërisht pas kontrollit dhe bastisjes që i është veturës së llojit VW-Passat , me targa të regjistrimit ..... të cilin e drejtonte i pandehuri , me ç’ rast substanca është gjetur brenda në veturë , e mbështjellë në qese plastike,

-me çka ka kryer veprë penale : posedim i paautorizuar i narkotikëve , substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par 1 të KPRK-së.

Prandaj gjykata të pandehurin konform nenit 41, 42,43,46 ,49 ,50,51,52, 76 dhe nenit 275 par 1 të KPRK-së.

**E G J Y K O N :**

1. Me dënim me gjobë në lartësi prej 200 euro , e të cilën gjobë i pandehuri fare nuk do ta paguaj nëse në afat prej 1( një )viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale, **dhe**

**Me dënim të kushtëzuar burgu,**

2. Në atë mënyrë që ia përcakton dënimin me burg në kohëzgjatje prej 4 muajsh , e të cilin dënim i pandehuri fare nuk do ta vuaj nëse në afat prej 1 viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale

Obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej 15 euro -15 ditë pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

Substanca narkotike e llojit “Marihuan ,, në peshë prej 13.95 gr . KONFISKOHET

Shpenzime procedurale nuk ka pasur

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Pejë me dt.22.7.2016 kundër të pandehurit Sh. Z , ka ngritë aktakuzë PP/II. nr.810/16, për vepër penale : posedimi i paautorizuar i narkotikëve , substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par 1 të KPRK-së duke i propozuar gjykatës që pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësorë të pandehurin ta shpallë fajtorë , ta dënoj sipas ligjit dhe ta obligoj në pagimin e shpenzimeve procedurale .

Në shqyrtimin fillestarë i pandehuri – pasi që paraprakisht i është lexuar aktakuza , është njoftuar me të drejtat dhe detyrimet procedurale dhe pasojat e pranimi përkatësisht të mos pranimi të fajësisë- e ka pranuar fajësinë dhe ka manifestuar keqardhje për atë që i ka ndodhur. Këtë pranim fajësie gjyqtari – pasi që paraprakisht e ka marrë pëlqimin e prokurorit të shtetit, i bindur se pranim fajësinë i pandehuri e ka bërë ashtu siç e parasheh ligji – vullnetarisht dhe pa u ndikuar nga askush dhe në asnjë mënyrë -e ka pranuar .

Meqenëse i pandehuri e pranoi fajësinë gjyqtari kaloi në marrjen e vendimit lidhur me llojin dhe lartësinë e masës ndëshkuese , me ç rast i pati parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese. Rrethanë rënduese në rastin konkret gjyqtari nuk ka gjetur , kurse nga ato lehtësuese ka çmuar : pranimin e singertë të fajësisë , pendimin e thellë për këtë gjë, qëndrimin korrekt në gjykatë, pa dënueshmërinë e mëparshme , gjendjen e varfër ekonomike , faktin se i pandehuri është mbajtës i familjes prej 5 anëtarësh , dhe kësaj gjyqtari mendon se edhe me një vendim si në dispozitivin e aktgjyqimit ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me neni 41 të KPK-së .

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 450 të KPPRK-së.

Vendimi mbi konfiskimin substancës narkotike është marrë konform nenit 62 par 2 pika 2.7 dhe nenit 69 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë konform nenit 365 të KPPRK-së u vendos si më lartë.

Nga Gjykata Themelore në Pejë D.P. datë.17.8.2017.

Sekretarja juridike  
Gjyljeta Çorkadiu

Gjyqtari  
Sejdi Blakaj

### **KËSHILLA JURIDIKE**

Kundër këtij aktgjykimi lejohet  
Ankesa në afat prej 15 ditësh nga  
Dita e marrjes , Gjykatës të Apelit në Prishtinë  
E përmes kësaj Gjykate .